



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-26603/20
Kaçanik, 26.10.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX-të** (Nëntë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 26 Tetor 2020. Për shkak të distancës fizike lidhur me pandeminë Covid-19, mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës – Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët ishte, Arbnora Kuka.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IX-të (Nëntë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 24 Tetor. Para se më prezantuar rendin e punës, a ka kush diçka me shtuar ?

z. Ekrem Kyçyku, Kërkoj që pika 2 e rendit të punës e propozuar që ka të bëjë me, Raporti Nëntëmujor financiar për periudhën: Janar- Shtator 2020, të shtyhet për mbledhjen vijuese, pasi që materiali për këtë pikë na ka ardhur me vonesë.

z. Nexhat Loku, Materiali për Raportin financiar na ka ardhur me vonesë, mirëpo pasi çështja trajtohet edhe në KK, unë jam të trajtohet sot në këtë mbledhje.

znj. Pranverë Loku, Edhe unë jam e mendimit që, Raporti financiar për kundër faktit që ka ardhur me vonesë, të trajtohet sot në KPF, pasi që trajtohet edhe në KK,

Kryesuesi i Kuvendit – Kemal Mërseli, Është Kërkesa e Ekrem Kyçyku që Raporti Nëntëmujor financiar për periudhën: Janar- Shtator 2020 të shtyhet për mbledhjen vijuese. Raportin mundemi me shqyrtuar në këtë mbledhje, por e kemi një kërkesë për shtyrjen e tij për mbledhjen vijuese për arsyt e theksuara, andaj kërkesa e këtij lloji duhet me marrë parasysh, pasi është obligim ligjor që materiali i mbledhjes t'iu ofrohet anëtarëve me kohë. Atëherë për këtë mbledhje propozoj për shqyrtim këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;

2. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020; dhe
3. Informatë e DAK për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020.

Raporti Nëntëmujor financiar për periudhën: Janar- Shtator 2020 e paraparë në rend pune si pikë e 2 sipas ftesës për mbledhje hiqet nga rendi i punës, ndërkaq pikët tjera 3 dhe 4 ç vendosën si pikën 2 dhe 3. Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, rendin e propozuar të punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 3 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri me vërejtjen e z. Ekrem Kyçyku, në f. 2 të diskutimi i tij, hiqet pasuesi “çështjet gjinore” shtohet pasuesi “në asnjë investim kapital nuk është përfshirë buxheti i përgjithshëm gjinor” pastaj vazhdon teksti tjetër. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VIII-të (Tetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 24 Shtator 2020 / Lënda: 01Nr. 060/01-23176/20.

Procesverbali do të publikohet i korrigjuar.

2. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, drejtori është prezent këtu për na dhënë sqarime të nevojshme. Paraprakisht kam një pyetje për drejtorin, të pika 4. Transferi i mjeteve nga fondi burimor 10, Shërbimet e shëndetësisë primare në shumë 7,400.00€, transferohen në të njëjtin kod Shërbimet e shëndetësisë primare. A mos është bërë ndonjë gabim teknik të ky transfer.

z. Bahri Selimi- drejtor i DEFZH, Të pyetja e kryesuesit, të pika 4, transferet e mjeteve nga kategoria ekonomike shpenzimet komunale fondi burimor 10 nga Nën programi, Shërbimet e shëndetësisë primare, shuma 7,400.00 € transferohen në kategorinë ekonomike Mallra e shërbime të Nën programi i shëndetësisë primare shuma 7,400.00€.

Jemi në fund të vitit, qëllimi është me realizuar buxhetin në formë më të lartë, aty ku kemi mjete të lira, brenda mundësive buxhetore me bërë transferin e mjeteve buxhetore të pashpenzuara. Një obligim që e kemi përmendur edhe në seancën e kaluar e kemi të kontrata kolektive për punëtorët e arsimit. Mjetet e rezervës që i kemi pasur nuk kanë mjaftuar, kështu që disa projekte që parashihen disa pengesa për realizimin e tyre, ato mjete kanë më shkuar në kompensim e arsimtarëve sipas kontratës kolektive. Të Nën programi 17528 që është buxheti dhe financa, bartet një shumë e mjeteve për shpronësime, të arsimit fillor 25.814.00€ Nga Nën programi 66445 Planifikimi urban dhe mjedisi, transferohet shuma 60,175.00€ nga kodi i projektit, Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale, bartën në arsimin fillor, të mesëm dhe administratën e arsimit.

Transferi i mjeteve nga Nën programi, Administrata e Arsimit, Renovimi i objekteve kulturore dhe infrastrukturë shkollore, transferohen në Mallra dhe Shërbime të Arsimit fillor.

Mundësia është me ndalur inicimin e procedurës përmbartimore e cila procedurë nëse iniciohet e rritë konston. Jemi angazhuar shumë në këtë drejtim që mos të shkon lënda në procedurë përmbartimore. Ju falënderojmë deri me tani që i keni miratuar kërkesat tona, ndërkaq jemi ndër

komunat e para që jemi duke i kryer obligimet në bazë të kontratës kolektive, e që ne pjesën dërmuese po i kryejmë me fondin rezervë, dhe me këtë vendim 100% i kryejmë obligimet ndaj arsimit sipas kontratës kolektive.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuaat sqarimet e drejtorit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, ndoshta i bien konflikt interesi se jam punëtor i arsimit, mirëpo e kemi përkrahur edhe herën e parë bartjen e këtyre mjeteve. Është mirë që i kemi pasur mjetet nga rezerva që mos me pësuar ndonjë projekt kapital. Edhe pse nuk është faji i komunave kontrata kolektive, por po duhet me planifikuar ku me i marrë këto mjete që mos të pëson ndonjë projekt.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

**Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020 dhe i njëjti i ,
Rekomandohet
Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

3. Informatë e DAK për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, Drejtori është prezentë për me dhënë sqarime të nevojshme në këtë pikë. Për këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, E dimë se ka qenë i vështirë fillimi vitit të ri shkollor, për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19. Pyetja ime për drejtorin e DAK. Sa është realizuar mësimi online, A ka pasur nxënës që nuk kanë pasur mundësi me u kyçur në mësim online për shkak të kushteve teknike ? dhe A kanë mundur me u kyçur në mësim online nxënësit me nevoja të veçanta ?

z. Selim Reka, Është fakt që është vit i vështirë për të gjithë e në veçanti për prindër ashtu edhe për mësimdhënësit, sepse na ka zënë pa përgatitur. Edhe pse jemi mobilizuar aq sa kemi pasur mundësi, me arritur një rezultat, rezultati të dal pak më i lartë, sepse ka qenë shkresë e ministrit që nuk guxojmë më i lënë notë më të vogël sesa e ka pasur nxënësi më herët. Është fakt që një pjesë e nxënësve nuk kanë pasur mundësi me u qasur online. Duke u bazuar në këtë, ne arsimtarët jemi përgatitur edhe gjatë verës me trajnime që sadopak me qenë me të përgatitur së vitin e kaluar, mirëpo të nxënësit, megjithëse kanë punuar profesorët e informatikës në këtë drejtim, ende ka me pasur probleme, për atë ne të gjithë jemi përcaktuar me punuar me variantin A, ishte vendim unanim i mësimdhënësve, taskforcave që të fillojmë me këtë variant. Unë mendoj se kjo formë do të jetë më e mira sesa mësimi online. Është mirë që deri me tani nuk kemi pasur raste të infektuar, dhe nëse ndodhë me pasur, nuk duhet të marrim vendime të shpejta me u mbyllur shkollat, mund të mbyllet një shkollë ku ka të infektuar për dy javë, por jo të gjitha shkollat, sepse mësimi i drejtpërdrejtë është më efektiv. Shqetësuese është numri i madh i mungesave si të nxënësve ashtu edhe të arsimtarëve. Të arsimtarët ka arsye në raste të caktuara, ka raste edhe të papërgjegjësive, por duhet angazhohemi për uljen e tyre dhe të krijojmë kushte t'i bëjmë shkollat sa me atraktive më të bukura për syrin e njeriut, së vërtetë ka nevojë, kur dihet fakti se në kohërat e mëhershme ka pasur kabinete, ndërkaq sot nuk ka, përveç kabineteve të informatikës. Komuna duhet me iu dhënë prioritet shkollave, sidomos informatikës për me i pajisur shkollat me pajisje, laptop etj.

z. Zahir Doda-drejtor i DAK, Sipas statistikave tona, 10 % e nxënësve nuk kanë mundur me u kyçur në mësim online, megjithatë ka pasur mundësi me i përcjellë të gjithë mësimin online sepse TV kanë të gjithë. Në shumë vende ka munguar mos kyçja e arsimtarëve dhe nuk kemi pasur çka me bërë se nuk kemi pas përgatitje të nevojshme. Kjo ka qenë arsyeja që gjatë verës me mjete të komunës kemi organizuar trajnime për arsimtarë për çdo shkollë për përdorim të teknologjisë informative që me na ndodhë nëse kalohet në mësim online me qenë të përgatitur për këtë formë. E vetmja SHF në Kotlinë dhe një pjesë e mësimdhënësve të SHF të Bobit nuk janë trajnuar, përndryshe arsimtarët tjerë i kanë përcjellë trajnimet. Fëmijët me nevoja të veçanta, nuk kam ndonjë statistikë sesa nuk e kanë përcjellë mësimin online, kush ka pasur kushte ka mundur me u kyçur, trajtimi në atë periudhë ka qenë i njëjtë për të gjithë nxënësit. Një përkujdesje të veçantë si komunë e kemi për ata persona, dhe duhet të krenohemi për këtë. I kemi shifrat e sakta për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, janë mësimdhënësit që merren me këtë kategori, të gjithë ata që kanë nevojë për transport për: Ferizaj, Prizren apo Prishtinë, kjo është e kryer. Ata që lëvizin këtu pari e kanë përkrahjen financiare, edhe prindërve të tyre iu kemi proceduar mjete për me bartur fëmijën e vet. Të gjimnazi na mungojnë kabinetet për shkak të hapësirës, përndryshe nga viti i kaluar kemi pasur prioritet furnizimin e shkollave me kabinete. Vitin e kaluar janë furnizuar shkollat që kanë pasur mundësi me 12 kabinete, 6 të fizikës, 6 të biologjisë. Sivjet janë në procedurë 12 kabinete tjera për të cilat e kemi nënshkruar kontratën, 3 të kimisë, për shkollat që kanë kushte. Kërkesat janë në ministri për aneksin e Gjimnazit dhe për shkollën “Emin Duraku” kushdo që ka mundësi me pasur ndikim, sepse prioritet e kam me shtyrë me kaluar kërkesa për vitin 2021 shkolla “Emin Duraku”, ndërkaq për kabinete bëhet lehtë nëse ekzistojnë hapësirat shkollore. Shumica e shkollave sivjet me vit të ri kanë me i pasur kabinetet e; fizikës dhe biologjisë, ndërkaq tri shkolla kanë me i pasur kabinetet e kimisë të kompletuara me të gjitha elementet. Çështja e pandemisë, deri tani nuk ka pasur ndonjë rast, ka pasur testime individuale dhe masive kolektive kanë shkuar një grup, ka pasur shkolla ku kanë shkuar në formë kolektive dhe nuk ka pasur ndonjë infektim. Ka pasur ndonjë informatë për ngritje të temperaturës, e cila me vonë është kthyer në gjendje normale. Sivjet me ndodhë çështja e pandemisë, jemi pak me të përgatitur për mësim online, por nuk janë të kompletuara krejt pajisjet, ka disa donacione, ka disa shpërndarje, megjithatë është problem me u realizuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se KPF, u,

Njoftua

Me Informatën e DAK për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka. Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:32.. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 7 anëtarë. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me datë 30 Tetor 2020 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kamal Mërseli

